

URDHËR
Nr. 85, datë 18.5.2026

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave zëvendësministrit z. Endrit Yzeiraj.
2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Financave, deleguar sipas pikës 1 (një) të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data 19.5.2026 deri më datë 20.5.2026.
3. Ngarkohet zëvendësministri, z. Endrit Yzeiraj, për zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj